

FJALORI

Termat Kryesore të Sigurimeve

SH. S. SH

SHOQATA E SIGURUESVE SHQIPTARË

2017

Bashkëautorë

Valier Lula

Adi Nana

Agjent sigurimesh (Insurance Agent): Është person fizik i licensuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes, që ushtron veprimtari kundrejt pagesave dhe komisioneve në tregun e sigurimeve, në emër dhe për llogari të Shoqërisë së Sigurimeve.

Aksident (Accident): Aksidenti nënkupton një fatkeqësi të papritur, ngjarje të paparashikuar ose të kryer paparamendim nga ana e të siguruarit.

Aktuari (Actuar): Është personi i licensuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes, i cili ka si detyrë kryesore llogaritjen e tarifave të primeve, tabelave të probabilitetit, provigjoneve dhe dividendëve, duke u mbështetur në teori shkencore që lidhen me investimet, statistikën, matematikën, financën dhe demografinë.

Avaria e Përgjithshme (General average): Ky term përdoret në sigurimin e marinës dhe mbulon shpenzimet e bëra nga kapiteneria e anijes, në rastin e shpalljes së avarisë së përgjithshme. Këtu përfshihen dëmtimet ose humbjet e një pjese të mallrave, për të kufizuar humbjet.

Bashkësigurim (Co-insurance): –Është sigurimi i kryer nga dy ose më shumë sigurues, të cilët ndajnë riskun në mënyrë proporcionale dhe janë në marrëdhënie direkte me të siguruarin.

Bordero (Bordereau): Janë pasqyra të hollësishme për rreziqet e marra nga siguruesit, për llojet e sigurimeve të mbuluara në risigurim. Borderot zakonisht përpilohen çdo 3-mujor dhe i dërgohen shoqërisë kryesore të risigurimit.

Breakdown Insurance: Termi “breakdown” nënkupton djegien, dëmtimin e makinerive të ndryshme ose pjesëve të tyre. Ky sigurim mbulon të gjitha rreziqet dhe aplikohet në përgjithësi për sigurimin e pajisjeve e makinerive elektrike, pompave dhe kompresorëve si pjesë e sigurimeve inxhinierike.

Broker sigurimesh (Insurance broker): Është personi fizik i licensuar nga Autoriteti për të ushtruar veprimtarinë e brokerimit në sigurime.

Byroja Shqiptare e Sigurimeve (Insurance broker): Është person juridik i krijuar jo për qëllime fitimi, e cila ka në anëtarësinë e saj çdo kompani sigurimi të licensuar në Republikën e Shqipërisë. Ky ent ka për qëllim kompesimin e palëve të treta të dëmtuara nga mjetet e pasiguruara nga sigurimi detyrueshëm, nga mjetet e paidentifikuara, dhe nga mjetet e pajisura me karton jeshil të huaj.

Captive Insurance Company: Janë shoqëri sigurimi të krijuara nga grupe të mëdha biznesi, të cilat bëjnë sigurimin e shoqërisë mëmë dhe të degëve të saj. Kjo mund të quhet edhe forma më e sofistikuar e vetësigurimit.

Data e fillimit të sigurimit (Inception date): Data në të cilën sigurimi hyn në fuqi.

Dëmshpërblimi : Është shuma për të cilën siguruesi i detyrohet të siguroarit, përfituesit apo çdo pale të tretë të dëmtuar, e cila rrjedh si e drejtë nga një kontratë sigurimi apo veprimtari sigurimi.

Dëm (Claims): Është dëmtimi i pasurisë, shëndetit, apo jetës së personit të siguar, nga një ngjarje aksidentale e papritur, e cila është brenda fushës së mbulimit të policës së sigurimit.

Dëme në proces (Outstanding claims): Kërkesat për dëmshpërblim, praktikat e të cilave nuk mbyllen brenda vitit ushtrimor.

Dosja e dëmit (Claim file): Dosja me të gjitha detajet, korrespondencën e nevojshme, dhe dokumentacionin për trajtimin e një kërkesë për dëmtim.

Eksperiencia e dëmeve (Claims experience): Është historia e dëmeve të të siguarit, që përfshin të gjitha shpenzimet dhe frekuencën e dëmeve të ndodhura për një periudhë kohe. Ky është një element shumë i rëndësishëm në momentin e marrjes në sigurim dhe llogaritjen e primit të sigurimit.

Ekspert dëmi (Loss adjuster): Specialist i nivelit të lartë, i cili trajton në mënyrë të pavarur dëmet në sigurime për siguruesin dhe përfiton një pagesë bazuar në investigimin dhe vlerësimin e dëmit. Këta ekspertë këshillohen të merren për raste të dëmeve me vlera të larta dhe problematike.

Eksperti Vlerësues Dëmsh në Sigurime: Është personi i licensuar nga Autoriteti si i tillë, i cili mund të jetë punonjës i shoqërisë së sigurimit ose i pavarur, që ka për detyrë të mbledhë të dhënat për rastin dhe të kryej përlllogaritjen e dëmit që duhet të paguhet nga shoqëria e sigurimit, si rezultat i ndodhjes së ngjarjes së siguar.

Ekspozimi (Exposure): Ky term në sigurime përdoret për tre arsye: 1. Përcaktimin e mundësisë së dëmit në objektin që do të sigurohet. 2. Shtrirjen e rrezikut në të ardhurat dhe pagesat vjetore. 3. Vlerësimin e mundësisë së humbjes së pasurisë së siguar për shkak të rrethanave të shkaktuara ndaj objektit të siguar.

Fondet e sigurimit të jetës (Life insurance funds): Fondet e sigurimit të jetës përfaqësojnë grumbullimin dhe ruajtjen e kontributeve të policëmbajtësve. Këto fonde përdoren nga shoqëritë e sigurimit të jetës për të përballuar kërkesat për dëme.

Franshiza (Franchise): Shumë e caktuar në policën e sigurimit, deri në masën që siguruesi nuk është i detyruar të paguajë në rast dëmi ose humbjeje.

Garanci (Warranties): Është policë sigurimi e cila garanton zbatimin e kushteve të një kontrate dhe dëmshpërblen përfituesin në rast të moszbatimit të kontratës.

I siguruar (Insured): Pala që ka siguruar risqet e tij nëpërmjet një policë sigurimi, me objekt humbje të mundshme pasurore dhe/ose jopasurore. Në disa raste i siguruari njihet dhe si policëmbajtës (Policy-holder).

Kartoni Jeshil (Green card): Është çertifikatë ndërkombëtare sigurimi, e cila lëshohet për mjetet motorike që udhëtojnë jashtë territorit të vendit në të cilin ky mjet është regjistruar. Kjo policë/certifikatë mbulon përgjegjësinë e palëve të treta, pra të gjitha dëmet që shkaktojnë mjetet e pajisura me të, në territoret e vendeve ku ky sigurim është i vlefshëm.

Katastrofa (Catastrophe): Përfshin humbjet si rezultat i ngjarjeve si: uraganë, përmytje, tërmet, zjarr masiv, etj.

Kërkesa për dëmshpërblim: Kërkesë e bërë nga i siguruari për një dëmtim ose përfitim, sipas një police sigurimi.

Kësti mujor i primit (Instalment monthly premium): Kur është rënë dakord që primi vjetor i policës së sigurimit do të paguhet me këste mujore. Mospagesa e këstit në afatin e përcaktuar sjell pezullim dhe më pas zgjidhje të kontratës së sigurimit.

Klasat e sigurimeve (Business classes): Shoqëritë liçensohen nga Autoriteti i Mbikqyrjes për klasa të përcaktuara, në mbështetje të Ligjit për Sigurimet dhe Risigurimet. Klasat janë të përcaktuara për shoqëritë e sigurimit të jetës dhe jo jetës.

Komision (Commission): Shpërblimi që i paguhet ndërmjetësit të sigurimeve (agjent ose broker) për shërbimin e kryer.

Kompani Fronting (Fronting Company): Kryerja e një sigurimi të caktuar nga një sigurues, nëpërmjet një siguruesi tjetër.

Konfirmim (Endorsement): Nen që i shtohet ose është pjesë e një kontrate sigurimi, që përmban disa alternativa në kushtet e sigurimit. Konfirmimet mund të shtohen gjatë inspektimit ose pas ndryshimeve të bëra me marrëveshje midis palëve.

Kushtet e Përgjithshme (General Conditions): Në të gjitha rastet policat e sigurimit janë të shoqëruara me kushtet e përgjithshme, në vartësi të llojeve të risqeve që mbulojnë. Kushtet kanë forcën e ligjit për palët, të cilat rregullojnë gjithë marrëdhënien e tyre të sigurimit.

Marrja në sigurim (underwriting): Është një proces që kryhet nga siguruesi ose specialisti i marrjes në sigurim (*underwriter*). Në këtë proces vendoset nëse do të pranohet kërkesa për t'u siguruar, e nëse vendimi është pozitiv përcaktohen kushtet e sigurimit. Në këtë rast hartohet një raport inspektimi (survey report) me shkrim nga specialisti i marrjes në sigurim dhe në të gjitha rastet, siguruesi ka të drejtën e pranimit të rrezikut për llogari të tij.

Marrëveshja CMR (CMR agreement): Është një marrëveshje që përmban kushtet kombëtare dhe ndërkombëtare të transportit të mallrave në rrugë. Disa nene të kësaj marrëveshje kanë të bëjnë me sigurimin e tyre.

Metoda pro rata (Pro rata method): Kur dy ose më shumë shoqërive të sigurimeve u është kërkuar të likuidojnë një dëm të siguruar prej tyre, ku secili prej tyre sipas kësaj metode, do të paguajë pjesën e dëmit të mbuluar, sipas raportit që ka në shumën e siguruar.

Ndryshimi i riskut (alteration of risk): Rritja e rrezikut pas lëshimit të policës së sigurimit, si pasojë e ndryshimit të rrethanave, si futja në aktivitetin e të siguruarit të metodave ose linjave të tjera të prodhimit, të cilat mund të shoqërohen me rritje të shkallës së rrezikut. Duke marrë parasysh që këto rreziqe nuk kanë qenë në kohën e lëshimit të policës së sigurimit, palët bien dakord të rivlerësojnë rrezikun duke bërë ndryshimet përkatëse në policë dhe në primin e sigurimit.

Nënsigurim (Under-insurance): Është sigurimi i kryer me shumë më të vogël se vlera reale e objektit të siguruar (riskut), që është e pamjaftueshme për mbulimin e plotë të dëmit.

Niveli i aftësisë paguese (Margin of solvency): Autoriti Mbikqyrës i Sigurimeve i kërkon të gjitha shoqërive të sigurimit të mbajnë një nivel të caktuar të aftësisë së tyre paguese. Kjo vlerë varion në vartësi të aseteve dhe rreziqeve të siguruara nga shoqëria e sigurimeve.

Pasqyra përmbledhëse (Schedule): Është pjesë e kontratës së sigurimit ku janë pasqyruar të dhënat kryesore të kësaj kontrate, si dhe objektet e siguruara me emërtimet e adresat përkatëse.

Përfituesi (Beneficiary): Personi i përcaktuar në policën e sigurimit si përfitues i shumës së sigurimit.

Përgjegjësia e punëdhënësit (Employers' liability insurance): Sigurim që mbulon punëdhënësin nga dëmet që mund t'i shkaktohen të punësuarve si pasojë e veprimtarisë së tij të ligjshme. Ky sigurim mbulon si dëmtimet shëndetësore dhe ato materiale të të punësuarve.

Përgjegjësia e punonjësve të Bankave BBB (Banker's Blanket Bond): Kjo policë sigurimi mbulon përgjegjësinë e punonjësve të bankave, të cilët kanë pozicione pune ku mund të kryhen veprime të pandershme ose mashtrime.

Përfjashtime (Exclusion): Në të gjitha policat e sigurimit ka disa nene ku përcaktohen fushat e rrezikut, për të cilat siguroesi nuk mbulon humbjet ose dëmet e ndodhura.

Përpjekje për shuarjen e zjarrit (Extinguishment damage): Polica standarde e zjarrit mbulon shpenzimet e bëra për eliminimin ose kufizimin e zjarrit, të cilat kufizojnë masën e dëmeve që mund të rezultojnë si pasojë e tij. Në përgjithësi shpenzimet, pjesë e kësaj kategorie janë të kufizuara dhe të përcaktuara në policën e sigurimit.

Pjesa e mbajtur (Retention): Ky term përdoret në marrëveshjet e risigurimit. Në këto marrëveshje siguruesi (ceduesi) i kalon pjesë të riskut risiguresit, ndërsa pjesën tjetër e mban vetë. Pjesa e riskut që vazhdon të mbahet nga ana e siguresit njihet me termin “*retention*”.

Pjesë e zbritshme (Deductible): Shuma ose përqindja e përcaktuar në policën e sigurimit, e cila mbulohet nga vetë i siguruari. Në të gjitha rastet kjo vlerë i zbritet vlerës së dëmit.

Policat e humbjes së parë (First loss policy): Sigurim sipas të cilit siguruesi paguan deri në shumën e siguruar, pa marrë në konsideratë vlerën totale të rrezikut.

Polica e Sigurimit (Insurance Policy): Është një kontratë ndërmjet siguresit dhe të siguarit, për mbulimin e risqeve të të siguarit sipas kushteve të përcaktuara në kontratë. Polica përpilohet nga siguruesi, ku çdo paqartësi sqarohet prej tij. Në disa raste për policën e sigurimit përdoret termi “*çertifikatë sigurimi*”.

Policë e Kombinuar Përgjegjësie (Combined liability policy): Policë përgjegjësie ku kombinohen dy ose më shumë lloje përgjegjësish në një policë të vetme. P.sh përgjegjësia civile e kombinuar me përgjegjësinë e produktit dhe përgjegjësinë e punëdhënësit.

Pool Insurance: Është një marrëveshje e siguresve për një klasë të caktuar sigurimi, nëpërmjet së cilës ata bien dakord të ndajnë primet dhe përgjegjësinë në një përqindje të caktuar midis tyre.

Primi (Premium): Shuma e paguar ose që duhet të paguhet nga i siguruari, për të mundësuar mbulimin me sigurim nga ana e siguresit.

Primet e shkruara (written premium): Janë të ardhurat bruto nga primet e deklaruara sipas klasave të sigurimeve gjatë vitit financiar.

Protection and Indemnity Clubs (P&I Clubs): Janë klube të krijuara në shekullin e 19-të, të cilat ndihmojnë pronarët e anijeve për sigurimin e tyre. Këto klube lëshojnë çertifikata sigurimi, ku ndër më të rëndësishmet janë ato të përgjegjësive për humbjen e jetës, pasurisë dhe dëmet mjedisore. Në disa raste ky sigurim njihet dhe si “*Ship owners’ liability*”.

Restaurim/Rikthimi (Reinstatement): Restaurim/rikthim i pronës së siguruar në gjendjen përpara ndodhjes së dëmit, në vijim të kërkesës për dëmshpërblim. Një nga metodat e restaurimit/rikthimit që haset kryesisht në sigurimin e mallrave e mjeteve motorike është “*Replacement*”. Restaurimi mund të konsistojë në zëvendësim, riparim, ose rindërtim.

Rezervat e dëmit (Claims reserve): Rezerva të llogaritura nga aktuarët e shoqërisë, për vlerën e secilit dëm, sipas rregullave të përcaktuara qartë nga Autoritet Mbikqyrëse e të pasqyruara në bilancet financiare.

Rezervat e primeve (Premiums reserve): Rezerva të llogaritura nga aktuarët e shoqërisë, sipas rregullave dhe metodave matematikore, të përcaktuara qartë nga Autoriteti Mbikqyrës e të pasqyruara në bilancet financiare.

Rrezikshmëritë (Hazards): Aspektet e risqeve që siguroesi parashikon se do të kenë rritje duke u influencuar nga ngjarjet dhe shkalla e dëmit, duke përfshirë në këtë parashikim edhe sjelljen e personave që janë pjesë e këtij risku.

Rrezik sigurimi– Është mundësia objektive e ekzistencës së humbjes pasurore dhe/ose jopasurore, e cila ndodh në rrethana të pasigurta, të panjohura dhe të pavarura nga vullneti i personit të siguruar.

Rreziqe Shtesë (Additional Perils): Janë mbulime të tjera përveç atyre kryesore, të përfshira në policën e sigurimit për një klasë të caktuar. Janë pjesë e policave specifike, si polica e sigurimit nga zjarri. Rreziqet shtesë në rastin e policës së sigurimit nga zjarri janë tërmeti, përmytja, stuhia, breshëri, thyerja e xhamave, etj.

Risigurimi (Reinsurance): Është procesi i sigurimit të riskut të marrë përsipër nga siguroesi tek risiguroesi.

Risigurimi fakultativ (Facultative reinsurance): Është një marrëveshje risigurimi, e cila mbulon me risigurim një risk të caktuar që nuk mbulohet nga marrëveshjet e tjera risiguroese që ka nënshkruar siguroesi.

Sigurim direkt (Direct insurance/Direct business): Është një transaksion direkt midis siguroesit dhe të siguarit, i kryer pa përfshirjen e ndërmjetësve (agjentët e brokerët).

Sigurim kompjuterik (Computer insurance): Është policë inxhinierike që mbulon rreziqe me madhësi të ndryshme duke filluar nga mikrokompjuterat e deri në sistemet kryesore. Ky sigurim mbulon dëmtimet e papritura të sistemeve, riparimin ose zëvendësimin, si dhe riformatimin e tyre.

Sigurim motorik (Motor insurance): Sigurimi i mjeteve motorike dhe përgjegjësitë që lindin si rrjedhojë e përdorimit të tyre. Ky sigurim ndahet në dy grupe kryesore: 1. Sigurimi i përgjegjësisë së mjeteve motorike ndaj palëve të treta, i cili në shume vende, duke përfshirë dhe vendin tonë, është i detyrueshëm 2. Sigurimi i vetë mjetit motorik (sigurim kasko), i cili është sigurim vullnetar.

Sigurimi (Insurance): Sigurimi është një sistem i transferimit të riskut dhe kombinimit të tij ku njëra palë, i siguruari, merr premtimin nga pala tjetër, siguruesi, për t'u dëmshpërblyer në rast humbjeje dhe siguruesi pranon të marrë përsipër riskun në këmbim të primit të sigurimit.

Sigurimi i besushmërisë (Fidelity guarantee insurance): Kjo policë siguron njëren palë nga veprimet e pandershme dhe të pakujdesshme të palës tjetër, si rezultat i të cilave shkaktohen dëme dhe humbje të pasurisë ose të të ardhurave.

Sigurimi i detyrueshëm (Compulsory insurance): Janë sigurimet e përcaktuara si të detyrueshme me ligj.

Sigurimi i mallrave (Cargo insurance): Ky sigurim përdoret kryesisht për sigurimin e mallrave ose makinerive gjatë transportit të tyre me të gjitha llojet e mjeteve të transportit. Kushtet kryesore të sigurimit të mallrave bazohen në klauzolat e Institutit të Mallit "A", "B" dhe "C". Në disa raste ky term mund të ndeshet edhe si "*Marine insurance*".

Sigurimi i montuesve nga të gjitha rreziqet (Erectors' all risks EAR): Policë sigurimi për të gjitha rreziqet, e cila mbulon montuesit gjatë montimit të makinerive të një objekti të përcaktuar dhe mbulon në sigurim periudhën nga fillimi i montimit deri në dorëzimin e tyre.

Sigurimi i ndërtuesve nga të gjitha rreziqet (Constructors' all risks CAR): Policë sigurimi që mbulon ndërtuesit gjatë ndërtimit të një objekti të caktuar për periudhën nga fillimi i ndërtimit të kantierit deri në përfundimin e punimeve. Kjo policë përmban disa rubrika kryesisht mbi dëmet në objekt, por ato mund të përfshijnë dhe makineritë e materialet e ndërtimit, rreziqet speciale, dëmet ndaj palëve të treta, etj.

Sigurimi i përgjegjësisë ndaj pasagjerit (Passenger liability): Kjo policë përcakton përgjegjësitë e drejtuesit ose përdoruesit të mjetit, për dëmtimet fizike ose humbjet e mundshme materiale të pasagjerëve gjatë përdorimit të mjeteve të transportit. Sigurimi në fjalë është i detyrueshëm dhe njihet si policë sigurimi për përgjegjësinë e mjeteve të transportit publik.

Sigurimi i përgjegjësisë së drejtuesve (Directors' and officers' liability insurance): Kjo policë mbulon dëmet dhe humbjet e palëve të treta dhe të punonjësve të thjeshtë, si pasojë e urdhrave e veprimeve të drejtuesve.

Sigurimi i pronarëve të shtëpive (Householder insurance): Ky sigurim përfshin ndërtesën, pajisjet e saj si dhe përgjegjësinë civile të pronarit ose anëtarëve të familjes së tij, për dëmet e shkaktuara ndaj palëve të treta.

Sigurimi i shëndetit në udhëtim (Travel Insurance): Ky është një sigurim për personat që udhëtojnë jashtë vendit. Ky sigurim është i vlefshëm për periudha të caktuara, në vartësi të kohës së qëndrimit jashtë vendit.

Sigurimi kufitar (Border insurance): Kjo policë sigurimi lëshohet për përgjegjësinë e zotëruesve ose përdoruesve të mjeteve motorike ndaj palëve të treta, për mjetet me targa të huaja, për periudhën e qëndrimit të tyre në territorin e Shqipërisë. Kjo policë vlen për rastet kur mjetet motorike nuk janë të pajisura me karton jeshil ose ai nuk mbulon territorin e Shqipërisë. Polica lëshohet për periudha të ndryshme kohore, minimalisht me një afat 15 ditor.

Sigurimi i trupit të anijes (Hull policy): Kjo policë sigurimi mbulon dëmtimet dhe humbjet në vetë trupin e anijes. Gati në të gjitha rastet kjo policë përfshin dhe sigurimin e makinerive të saj, në këto raste polica quhet “*Hull and Machinery Insurance*”

Sigurimi i vetë mjetit motorik (CASCO): Kjo policë mbulon dëmtimet ose humbjet e mjetit motorik, sipas kushteve të policës së sigurimit

Sigurimit nga të gjitha rreziqet (All risks): Është një term sigurimesh që përdoret kur në policë nuk është përcaktuar ngjarja e sigurimit, si psh zjarr, vjedhje, stuhi, përmbytje, etj. Mbulimi bazuar në këtë lloj sigurimi është i vlefshëm për humbjet ose dëmet, si rezultat i ndonjë ngjarjeje që nuk është parashikuar si pjesë e përjashtimeve.

Sigurues (Insurer): Është një shoqëri e licensuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes në fushën e sigurimeve, e cila merr përsipër të dëmshpërblejë dëmet nga një rrezik sipas kontratës/policës së sigurimit.

Sistemi Bonus-Malus (Bonus-Malus System): Ky është sistem që përdoret në sigurimet motorike. Aplikimi i këtij sistemi çon në uljen e primit të sigurimit, nëse gjatë periudhës së sigurimit, i siguruari nuk ka patur asnjë ngjarje sigurimi, ndërsa çon në rritjen e primit, kur i siguruari ka patur ngjarje sigurimi e ka shkaktuar dëme.

Shpenzime për marrje në sigurim (acquisition cost): Shpenzimet e kryera nga siguruesi për lëshimin e një police sigurimi.

Shpenzime për dëme (Claims expenses): Këtu përfshihen të gjitha shpenzimet direkte për investigimin, ekspertin e dëmeve, gjykatën etj, të cilat janë të pasqyruara qartë në pagesat e bëra.

Shpenzime për trajtimin e dëmit (Claims handling expenses): Janë shpenzimet indirekte për trajtimin dhe pagimin e dëmeve, bazuar në tarifat e vendit ku ka ndodhur dëmi, si dhe rregulloreve të shoqatave e institucioneve për trajtimin e dëmeve.

Shtresa (layers): Ky term përdoret kryesisht në marrëveshjet risiguruese, ku risku ndahet në shtresa.

Shuma Agregat (Aggregate): Shuma maksimale që duhet të paguajë një sigures për dëmet që ndodhin gjatë gjithë periudhës së sigurimit. Në përgjithësi ky term aplikohet më shumë për policat e sigurimit të përgjegjësive.

Shuma e sigurimit (kufiri i përgjegjësive): Është vlera, për të cilën është rënë dakord midis palëve në kontratën e sigurimit apo është përcaktuar në aktet ligjore apo nënligjore në fuqi për sigurimin e detyrueshëm dhe që përfaqëson kufirin maksimal të përgjegjësive së siguresit kundrejt të siguarit/përfituesit.

Shuma kapitale (Capital Sum): Ky term përdoret në policat e sigurimit të jetës dhe nënkupton shumën e pagueshme në rastin e humbjes së jetës nga i siguruari ose me plotësimin e afatit të përcaktuar në policën e sigurimit.

Shuma e Siguarar (Sum Insured): Janë asetet ose pjesa e aseteve të të siguarit që mbulohen me sigurim nga siguresi. I siguruari mund të sigurojë të gjitha asetet e tij ose një pjesë të tyre. Termat dhe masa e aseteve të siguruara reflektohen në policën e sigurimit.

Tarifa e Primit (Premium rate): Tarifa për njësi ekspozimi ndaj riskut. Rritja e riskut shoqërohet me rritje të tarifës së primit.

Të ardhurat vjetore (Annual turnover): Janë të ardhurat që realizohen për një vit kalendarik, nga biznesi apo individi, dhe që përdoren në llogaritjen e dëmit sipas policës së sigurimit përkatës.

Vjedhja dhe grabitja (Burglary/theft and robbery): Kjo policë mbulon dëmet ose humbjet në pasurinë e sigurarar si pasojë e vjedhjeve dhe/ose grabitjeve.